

VENDIM
Nr. 126, datë 3.3.2021

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 221, DATË 23.3.2016, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT
TË AGJENCISË SË TRAJTIMIT TË PRONËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 5, të nenit 26, të ligjit nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, të ndryshuar, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 221, datë 23.3.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 6 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“6. ATP-ja drejtohet dhe përfaqësohet nga drejtori i Përgjithshëm dhe nga dy zëvendës drejtorë të përgjithshëm. Zëvendës drejtorët e përgjithshëm përmbushin detyrat që u delegohen nga drejtori i Përgjithshëm. Drejtori i Përgjithshëm dhe zëvendës drejtorët e përgjithshëm i raportojnë ministrit të Drejtësisë.”.

2. Pika 7 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“7. Drejtori i Përgjithshëm i ATP-së emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga detyra nga Kryeministri, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, ndërsa zëvendës drejtorët e përgjithshëm emërohen, lirohen dhe shkarkohen nga detyra nga ministri i Drejtësisë, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm.”.

3. Pika 10 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“10. Në rastet kur pozicioni i drejtorit të Përgjithshëm mbetet vakant, detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit të Përgjithshëm të ATP-së, në zbatim të ligjit nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, ushtrohen drejtpërdrejt nga zëvendës drejtori i Përgjithshëm më i vjetër në këtë funksion. Detyrat dhe përgjegjësitë që ligji nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, ia ngarkon drejtpërdrejt drejtorit të Përgjithshëm nuk mund të ushtrohen nga zëvendës drejtori i Përgjithshëm.”.

4. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia e Trajtimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe